



PLANI I VEPRIMIT NGA REKOMANDIMET E AUDITORËVE TË JASHTEM PËR PF 2023-INFRAKOS SH A 31/05/2024

REKOMANDIMI NR	LIOJI I FUSHËS REKOMANDUE SE	Auditimi	Ndikimi	REKOMANDIMI	Dep. Përgjegjëse	ÇKA DUHET TË BËHET	KOHA E FILLIMIT TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMIT	KOHA E PËRFUNDIMIT TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMIT
ÇështjaB1 -	Mungesa e të dhënave kontabël për rezervën e rivlerësimi.	SNK 16 përkatësisht pika 39 përcakton se: Nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja kreditohet drejtpërdrejt tek kapitalet e veta me titullin mbivlerë (tepricë) rivlerësimi. Po ashtu SNK 16 përcakton se: një aktive afatgjate njihet si aktive nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen rrjedhin të njëjësia ekonomike dhe kosto e aktivitet mund të matet me besueshmëri. Ndërmarrja kishte prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar shumën 15,226,015€, si	Mungesa e dëshmimeve apo të dhënave analitike dhe mos regjistrimi i të dhënave kontabël në sistem e kontabilitet pamundëson verifikimin e rezervës së rivlerësimi si dhe vë në dyshim vërtetësinë e informatave financiare.	Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmerr veprime të menjëhershme në sigurimin e informatave lidhur me tepricën e rivlerësimi si dhe sigurojë se pasqyrat financiare vjetore të përgatiten duke u bazuar në të dhënat e konfirmuara kontabël dhe me dëshmitë e duhura.	BoD & Menaxhimet i	Sigurimi i burimeve financiare: aktualisht ne nuk kemi mundësi financiare të bëjmë një gjë të tilla me mjete vetanake, kërkesë nga INFRAKOS SHA për aksionarin është ndarja e mjeteve financiare për rivlerësim.	01.06.2024	31.12.2025

rezervë të rivlerësimit (tepricë). Megjithatë, për këtë vlerë të prezantuar, nuk ka arritur të na sigurojë të dhënat kontabël apo dëshmi për të vërtetuar shumën e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar. Kjo çështje nuk ishte korigjuar që nga viti 2011. Infrakos në planin e veprimit kishte potencuar se këtë çështje nuk mund të adresojnë për shkak të mungesës së informatave burimore dhe kjo mbetet të adresohet në momentin e rivlerësimit të pasurive.

Bazuar në konfirmimet zyrtare, kjo shumë është trashëguar nga ish Hekurudhat e Kosovës (Infrakos dhe Trainkos), për të cilat nuk ka dëshmi historike se e njëjta shumë është e bartur me saktësi.

Çështja A1 -	Mungesë e të dhënave të plota për grantet	<p>SNK 20, përcakton se Grantet qeveritare që lidhen me pasuritë, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, duhet të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiare ose duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë – detyrime ndaj grantit ose duke zbritur grantin që merret nga vlera e mbartur e pasurisë. Ndërmarrja në pasqyrën e pozicionit financiar kishte prezantuar detyrimet ndaj granteve në vlerë 40,080,848€. Megjithatë, ne kemi identifikuar se vlera prej 4,750,000€ e detyrimeve ndaj granteve nuk ishte e mbështetur në dëshmi mbështetëse si raport pranimi, apo ndonjë dëshmi tjetër relevante.</p> <p>Mungesa e dëshmive burimore ndërlidhët me studimin e fizibilitetit për projektin e "Linjës së 10 hekurudhore" dhe të cilat i referohen viteve të mëhershme.</p>	Prezantimi i granteve pa pasur dëshmi mbështetëse, mund të ndikon në mbivlerësimin/ nënvlerësimin e granteve dhe investimeve në vijim.	Bordi i Drejtorëve, duhet të sigurojë dëshmi relevante me rastin e regjistrimit të detyrimeve ndaj granteve me qellim që prezantimi në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	<i>PIU dhe Dep. Financave</i>	Do të sigurojmë dokumentet relevante të kërkuara për ta zbatuar këtë rekomandim. Kjo procedura veq ka filluar.	01.05.2024	31.12.2024
--------------	---	--	--	---	-------------------------------	--	------------	------------

		Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrollit të brendshëm për të siguruar në kohë dokumentacionin e nevojshëm dhe departamenti i financave ishte bazuar vetëm në një korrospodencë (email) nga njësi për implementim të projekteve në ndërmarrje lidhur me shërbimet e pranuar.						
Çështja B2	Mos rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes	<p>Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 16, pasuritë afatgjata materiale përcakton se: rivlerësimet duhet të bëhen në mënyrë të rregullt çdo tre deri pesë vjet, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e pasurisë nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.</p> <p>Ndërmarrja që nga viti 2007 e këndeje nuk kishte bërë rivlerësimin e pasurive të ndërmarrjes. Ne kemi analizuar regjistrin e pasurisë dhe</p>	Mos kryerja e rivlerësimit të pasurive të cilat ende janë në përdorim, rritë rrezikun që vlera kontabël e tyre e prezantuar në pasqyra financiare, të jetë materialisht e ndryshme nga vlera e drejtë.	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrin të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime për rivlerësimin e pasurive nga një vlerësues i licencuar. Në mungesë të mjeteve vetanake duhet shihet mundësia e sigurimit të mjeteve nga aksionari.	BoD& Menaxhimet i	Sigurimi i burimeve financiare, aktualisht ne nuk kemi mundësi financiare te bëjmë një gjë te tille me mjete vetanake - nëse do te sigurohen fondet e nevojshme atëherë ne jemi te gatshëm te fillojmë rivlerësimin sipas rekomandimit	01.06.2024	31.12.2025

kemi identifikuar se në këtë regjistër janë të përfshira 1,686 pasuri me kosto historike në shumën prej 7,573,844€, të cilat janë zhvlerësuar në tërësi dhe vlera neto e tyre në librat kontabël është zero (0).

Ne kemi vërejtur se regjistri i pasurive përmban 369 pasuri të cilat kishin koston historike 7.3 mil/euro dhe 1,317 pasuri tjera të cilat kishin koston historike 238 mijë/euro.

Fakti që pasuritë e ndërmarrjes si objektet, makineritë, ndërtesat e stacioneve hekurudhore, trafo stacionet e tjera janë në përdorim (aktive) dhe vlera neto në libra është zero konsiderojmë që duhet të bëjë rivlerësimi dhe rishikimi i jetëgjatësisë së tyre. Bazuar në konfirmimet e zyrtarëve, mungesa e rivlerësimit të pasurive kishte ndodhur për shkak se ndërmarrja në vazhdimësi ishte ballafaquar me mungesën

		e mjeteve financiare, dhe nuk kishte mundësi të kryej procesin e rivlerësimit.						
Çështja B3	- Mangësitë e Sistemit Informativ të Kontabilitetit	<p>Ligji nr. 06/L-032, Neni 11, Regjistrat kontabël përfshijnë regjistra të hyrjeve fillestare kontabël dhe regjistra mbështetës, siç janë kontrollet dhe regjistrat e transfereve të fondeve elektronike; faturave; kontratave; librave kryesor dhe ato dytësor, shënimeve në ditar dhe rregullimeve tjera në pasqyrat financiare të cilat nuk janë reflektuar tek hyrjet në ditar, dhe regjistrat si fletë pune që mbështesin alokimet e kostos, llogaritjet, barazimet dhe shpalosjet. Regjistrat kontabël ruhen në sistemin e regjistrimit të dyfishtë kontabël.</p> <p>Ne kemi identifikuar se Sistemi Informativ i Kontabilitetit të cilin ndërmarrja e ka në përdorim nga viti 2003 dhe përditësimi nuk ishte bërë që nga viti 2008. Sistemi</p>	Mos përditësimi i softuerit të kontabilitetit ka ndikuar që ky sistem i kontabilitetit nuk gjeneron raporte të përshtatshme analitike dhe të integruara të shënimeve financiare.	Bordi i Drejtoreve duhet të siguroj që sistemi informativ i kontabilitetit të gjeneroj të gjitha informacionet e nevojshme duke përfshirë ditarin kryesor. Gjatë procesit të blerjes ndërmarrja duhet të përcaktoj saktë komponentët që duhet të përmbaj sistemi informativ i kontabilitetit.	Dep. Financave	INFRAKOS SHA do të bëjë përpjekje për realizimin e këtij rekomandimi nga mjetet vetanake ne revidimin e planit të biznesit 2024, pasi që ky projekt nuk është i përfshirë në listën e projekteve për vitin 2024 që do të financohen nga ME.	01.06.2024	31.12.2024

kontabilitetit nuk gjeneron raporte të përshtatshme analitike dhe të integruara të shënimeve financiare. Po ashtu, nga viti 2014 ky sistem i kontabilitetit nuk kishte mirëmbajtje.

Gjatë vitit 2023 ndërmarrja kishte zhvilluar procedurat e kontraktimit për blerjen e sistemit të kontabilitetit dhe kishte lidhur kontratë për "Furnizim me softuer për menaxhimin financave dhe asetëve". Këtë projekt e kishte planifikuar të realizojme mjetet e financuara nga Ministria e Ekonomisë. Mirëpo, kjo kontratë ishte anuluar pasi që operatori ekonomik nuk i kishte përmbushur obligimet e saj kontraktuale.

Për kundër faktit, që ndërmarrja kishte lidhur marrëveshje kontraktuale për sigurimin e softverit të kontabilitetit, kjo kontratë ishte anuluar pasi që operatori ekonomik nuk i kishte përmbushur

		obligimet e saj kontraktuale.						
--	--	----------------------------------	--	--	--	--	--	--